



Shumëgjuhësia dhe edukimi i hershëm

Të folurit me fëmijët në gjuhët e familjes
dhe njohja me format edukative

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	3
Shumëgjuhësia në jetën e përditshme të familjes Shumëgjuhësia në jetën e përditshme të familjes	4
Oferta për edukimin e hershëm Grupe familje-fëmijë, takime të familjes me fëmijë nga 0-3 vjeç	6
Qendrat e kujdesit për fëmijë dhe çerdhet	8
Lista e adresave	10
Informacion i mëtejshëm	11





Të nderuar prindër,

a flisni më shumë se një gjuhë, gjegjësisht gjuhë të ndryshme nga gjermanishtja në familjen tuaj? Atëherë ju dhe fëmija juaj keni një avantazh të madh: Fëmija juaj mund të dalë shumëgjuhësh nga gjuhët e familjes suaj si dhe nga gjuha gjermane që flitet në ambientin përreth. Këta fëmijë përbëjnë një shumicë në popullsinë botërore, pasi rritja me disa gjuhë dhe të folurit e disa gjuhëve tanimë është normale dhe një shans i madh për shtigje të mëtejshme jetese, mësimi dhe karriere.

Si rregull, fëmijët që rriten me dy a më shumë gjuhë nuk kanë vështirësi në përvetësimin e gjuhëve. Përkundrazi: Pavarësisht se çfarë gjuhësh përfitohen në fëmijëri, kjo mund të ketë një ndikim pozitiv në mësimin e më shumë gjuhëve. Si familje shumëgjuhëshe, përkrahni gjuhët e familjes suaj, që të ruhet një pjesë e mirë e identitetit të familjes suaj. Do të donim t'ju prezantonim me këtë broshurë se si mund ta ndihmojmë fëmijën tuaj të mësojë gjermanisht në gjuhën e ambientit përkatës dhe se çfarë ofertash ka pranë jush.

Ihr

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen

Shumëgjuhësia e hershme

Shumëgjuhësia në jetën e përditshme të familjes

- Shoqëroni aktivitetin tuaj edhe nga ana gjuhësore: Fëmija juaj ua njej zërin që nga gjiri. Ai është i njohur për të dhe ka efekt qetësues. Flisni vazhdimisht gjuhën e familjes, që fëmija të ndjejë afërsi, siguri dhe ngrohtësi.
- Të rriturit me më shumë se një gjuhë për fëmijën tuaj është një dhuratë, pasi shumëgjuhësia ka shumë avantazhe afatgjata. Gjuhët e familjes do ta shoqërojnë fëmijën tuaj gjithë jetën. Është e rëndësishme, që t'i flisni fëmijës suaj që në fillesa dhe me gëzim. Edhe nëse nuk e kupton ende brendinë, fëmija është i gëzuar për të folur tuaj.
- Zgjojini fëmijës dëshirën e të folurit, duke folur shpesh e çdo ditë gjuhën që flisni më mirë.
- Edhe nëse fëmija juaj është nën kujdesin e çerdheve apo të qendrave përkatëse, gjuha e familjes suaj ka ende rëndësi të madhe, duke qenë se fëmija krijon një lidhje me ju, Gjegjësisht me familjen e vet përmes kësaj gjuhe dhe përjeton kujdesin dhe sigurinë.
- Gjuha e dytë, gjermanishtja, do të ketë gjithashtu një rëndësi të veçantë për të ardhmen e fëmijës suaj p.sh. kur krijon shoqëri ose dhe më vonë në shkollë. Sa më mirë të mësojë të flasë një gjuhë fëmija aq më lehtë mund të mësojë gjuhët e tjera. Ndaj dhe gjuhët e familjes suaj janë një bazë e rëndësishme për mësimin e mëtejshëm të gjuhëve, për shembull, të gjuhës së dytë, gjermanisht.

Leximi me zë

Shikimi dhe leximi së bashku i librave me figura e ndihmon fëmijën të mësojë të flasë. Ka tanimë libra me figura për foshnje (edhe shumëgjuhëshe). Bibliotekat publike në qytet ofrojnë një larmi të gjerë librash (shumëgjuhëshe) për më të vegjlit, të cilat mund të huazohen pa pagesë ose kundrejt një pagese të vogël.



Bibliotekat e qyteteve mund t'i gjeni në fund të kësaj fletushke

Guten Morgen, Clara! Komm, wir ziehen deine Sachen aus. Da haben wir deine **Mütze!** Die Mütze legen wir hier in dein Fach. Was ziehen wir jetzt aus? Stimmt, die **warme Jacke.** Den **rechten Ärmel** ausziehen und den **linken Ärmel** ausziehen.

Die **Jacke** hängen wir an den Haken. Jetzt ziehen wir **deine Schuhe** aus und stellen sie unter die Bank. Wo sind deine **Hausschuhe?** Da sind deine Hausschuhe. Die ziehen wir noch an und dann bist du fertig.



Mund të jeni një model gjuhësor për fëmijën nëse flisni gjatë veprimeve.

Duke përmendur me fjalë se çfarë bëni, jeni duke i ofruar fëmijës fjalë të reja. Përmes përdorimit të përsëritur të termave, fëmija i lidh me aktivitetet dhe zgjeron kështu fjalorin. Kjo ofron dhe një bazë të rëndësishme për zhvillim gramatik: Fëmija kupton se fjalitë, si dhe aktivitetet shoqëruese, ndjekin struktura të caktuara.

Lëvizje dhe muzikë

Studimet konfirmojnë se lëvizja dhe këndimi e ndihmojnë fëmijën të flasë. Në lëvizje, fëmija mund t'i përfjethë fjalët përmes veprimeve të veta apo në trupin e vet.

Krijoni raste të zakonshme ku fëmija mund të përfjethë muzikën dhe/ose të lëvizë vërdallë. Ka madje shumë oferta në të cilat fëmija mund të këndojë në grup, të bëjë fizkulturë e të luajë me të tjerët teksa ju si prind mësoni këngë apo lojëra të reja për fëmijën. Kjo i lejon fëmijës të bjerë në kontakt përmes lojës me gjuhën gjermane.



Ofertat me lëvizje e muzikë mund t'i gjeni në fund të fletushkës

Und wir singen unser Lied zur Begrüßung: „Das ist gerade, das ist schief ...“

Genau, das ist gerade.

Rade! Rade!



Oferta për edukimin e hershëm

Grupe familje-fëmijë, takime të familjes (fëmijë të moshës 0 – 3 vjeç)

Ka shumë oferta që ndihmojnë familjet të njihen me njëra-tjetrën, të shkëmbejnë përvoja dhe të marrin këshilla për çështje edukative dhe të jetesës në familje. Shpesh këtu mund të krijohen dhe miqësi apo komunitete të reja. Të gjitha ofertat edukative synojnë t'ju mbështesin e shoqërojnë juve dhe fëmijën tuaj. Një bashkëpunim i këndshëm me personat e kontaktit apo ekspertët ndihmon gjithashtu që fëmija të ndihet komod me ofertat apo edhe më vonë në qendrën e kujdesit apo në çerdhe.

Shumë prindër raportojnë se ndonjëherë ndihen të vetëm në detyrimet familjare pas lindjes së fëmijës. Takimet/kafetë me familjen apo prind-fëmijë ofrojnë shansin që ju dhe fëmija të jeni në kontakt me prindër e fëmijë të tjerë që në fazat e hershme. Keni mundësinë të hani mëngjesin me familje të tjera, për shembull, ose të uleni pasditeve së bashku për kafe e ëmbëlsira. Atje fëmijët kanë shumë mundësi për të luajtur, si dhe ka edukatorë specialistë për konsulencë nëse keni pyetje.

Ka shumë grupe të posaçme prind-fëmijë, p.sh. për prindërit shumëgjuhësh ose vetëm për baballarët, ose vetëm për nëna, ose për prindër beqarë. Grupet mund të vizitohen që në vitin e parë të fëmijës suaj dhe mund të krijohen në vende të ndryshme, p.sh. në çerdhe, në spital, në kafeterinë e prindërve apo në qendrën e edukimit familjar. Grupet prind-fëmijë mund të përdoren për shkëmbim informacioni apo për promovimin e zhvillimit të fëmijës me një program të caktuar. Në shumë oferta dhe grupe mund të marrin pjesë dhe shoqëruet të tjerë me fëmijën tuaj (gjyshet, gjyshërit, tezet e hallat, dajat e xhaxhallarët, shoqëria). Thjesht pyesni menaxhuesit e grupit.



Pikat e kontaktit për grupet familje-fëmijë mund të gjenden në fund të kësaj fletushke

Ich freue mich, Dich kennen zu lernen. Mein Name ist Maya und das ist hier ist Noah. Jetzt können unsere Kinder zusammen spielen.



Sidomos në **grupet praktike** ka dhe përkthyes që mund t'ju ndihmojnë të nisni biseda. Për më tej, është e dëshirueshme të kontribuoni madje në gjuhët e familjes suaj. Të gjithë fëmijët rriten me vetëdijen e shumë gjuhëve. Duke vizituar këto grupe, e ndihmoni fëmijën të njihet me gjuhën gjermane.

Më shumë informacion mund të gjeni në adresën www.kommunale-integrationszentren-nrw.de/griffbereit

Në disa qytete ka madje kumbarë vullnetarë apo gjyshër zëvendësues që mund t'ju mbështesin në jetën e përditshme për një kohë të gjatë. Kumbarët mund të kujdesen për fëmijën tuaj për një kohë të shkurtër, të bëjnë blerje, t'ju shoqërojnë në vizitat me doktorin apo me autoritetet, si dhe të kujdesen për fëmijën tuaj. Kumbarët mund dhe të luajnë me fëmijën tuaj si dhe të flasin me të në gjermanisht.



Në disa qytete madje ka agjenci për kumbarët apo gjyshërit zëvendësues. Shikoni në fund të kësaj fletushke



Kujdesi në qendrën ditore të kujdesit të fëmijëve ose në institucionet e kujdesit ditor të fëmijëve

- Fëmija juaj mund të frekuentojë që herët një institucion të kujdesit ditor ose një qendër të kujdesit ditor për fëmijë. Atje ka një procedurë fikse, për shembull, ku fëmijët mirëprehen së bashku, ushqehen së bashku, luajnë dhe fitojnë eksperiencë të reja.
- Punonjësit e qendrave të kujdesit apo specialistët pedagogjik do t'ju ndihmojnë juve dhe fëmijën tuaj që të mësoheni me qendrën e kujdesit apo çerdhen. Në fillim madje mund të qëndroni atje së bashku me fëmijën tuaj.
- Fëmija do ta mësojë më lehtë gjuhën gjermane nëse vjen që herët në qendrat e kujdesit apo në çerdhe. Sa më shpejt që fëmija bie në kontakt me gjermanishten, aq më e lehtë do ta ketë të mësuarit e gjuhës së re. Atje do të marrë shumë sugjerime në gjermanisht nga punonjësit e qendrës apo specialistët pedagogjik, si dhe nga fëmijët e tjerë. Kjo i bën të mundur fëmijës suaj të dëgjojë e të flasë shpesh në gjuhën gjermane. Po ashtu do të krijojë shoqëri me fëmijë tjerë që flasin gjuhën gjermane apo dhe gjuhë të tjera.

Informacion mbi regjistrimet për kujdesin kundrejt fëmijëve gjani në linkun e mëposhtëm:

www.kita.nrw.de/eltern/kita-finder/kita-finder-nrw



Qendra ditore e kujdesit për fëmijë

- Në qendrën ditore të kujdesit për fëmijë ka grupe më të vogla sesa në çerdhe, dhe për fëmijët kujdesen të ashtuquajturit kujdestarë ditorë.
- Sidomos për fëmijët e vegjël (0 – 3 vjeç) qendra e kujdesit ditor është e përshtatshme për kalimin e parë nga familja drejt një oferte kujdesi dhe edukimi jashtë shtëpisë. Grupet më të vogla e bëjnë më të lehtë për disa fëmijë dhe familjet e tyre që të mësohen me ambientin e ri dhe me gjuhën gjermane.
- Kujdestarët e kujdesit ditor kanë marrë trajnimin e tyre të posaçëm për ta shoqëruar sa më mirë fëmijën tuaj. Ata ju ndihmojnë edhe juve, edhe fëmijën të kryptojnë kontakt me prindër dhe fëmijë të tjerë.
- Si prindër, ju do të informoheni për zhvillimin e fëmijës suaj si dhe për procedurat dhe kërkesat e qendrës së kujdesit ditor për fëmijë. Në këtë mënyrë kujdestarëte kujdesit ditor i japin rëndësi faktit që të gjithë prindërit ndihen të mirëpritur dhe se mund të kontribuojnë me gjuhët e familjes së tyre.
- Atje p.sh. organizohen aktivitete të përbashkëta, në të cilat janë të ftuar të gjithë prindërit.



Qendrën tuaj të specializuar për kujdesin ditor të fëmijëve e jeni në fund të kësaj fletëpalosje

Çerdhet






- Fëmija juaj mund të frekuentojë dhe çerdhen duke filluar nga viti i parë i jetës. Atje për fëmijët e moshave ndërmjet një dhe gjashtë vjeç kujdesen specialistë pedagogjikë. Disa institucione pranojnë dhe fëmijë që janë më të vegjël se një vjeç. Në varësi të moshës, ka grupe prej 10 ose 25 fëmijësh.
- Në çerdhe mbahen rregullisht të ashtuquajturat biseda me prindër, në të cilat do të informoheni për zhvillimin e fëmijës suaj, si dhe për rutinën ditore të çerdhes. Atje prindërit mund edhe të shtrojnë pyetje.
- Për më tej, ka aktivitete, takime informuese dhe festa në të cilat ftohen të gjithë prindërit. Është e rëndësishme që të gjithë prindërit mund të kontribuojnë, p.sh. përmes gjuhës së familjes së tyre.
- Në çerdhe gjuha e familjes suaj vlerësohet, p.sh. fëmija juaj mund edhe të flasë në këtë gjuhë. Për më tej, këndohen edhe këngë në këtë gjuhë dhe në gjuhë të tjera, ose kryhen projekte në të cilat fëmijët mësojnë gjuhë të ndryshme.








Pikë tuaj të kontaktit për një vend në çerdhe e gjeni në fund të kësaj fletëpalosje

Lista e adresave

 Oferta për aktivitete dhe muzikë

 Name	 Adresse	 Telefon	 Internet	 E-Mail

 Bibliotekat e qyteteve

 Name	 Adresse	 Telefon	 Internet	 E-Mail

Informacion i mëtejshëm

www.familienbildung-in-nrw.de//fuer-eltern/elternstart-nrw

www.griffbereit-rucksack.de

www.kita.nrw.de

www.ane.de/bestellservice/sprachentwicklung



Bundesstiftung
Frühe Hilfen 

Gefördert vom:



Bundesministerium
für Familie, Senioren, Frauen
und Jugend

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen

Völklinger Straße 4, 40219 Düsseldorf
Telefon: 0211 837-02
poststelle@mkffi.nrw.de
www.chancen.nrw

 @ChancenNRW
 @ChancenNRW
 Chancen_nrw
 Chancen NRW

